

## Vlerësimi i ndërsjelltë i EA

DPA kaloi me sukses vlerësimin e Organizatës Evropiane për Akreditim (EA) që vlerësoi tërësisht Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) në datat 1-5 Shkurt 2021 dhe 12-16 Prill 2021. Grupi i vlerësimit të ndërsjelltë të EA, i përbërë nga përfaqësues të organizmave evropiane të akreditimit, vlerësoi aktivitetet e DPA në vendndodhjen e saj në Tiranë dhe shoqëroi grupet e vlerësimit të DPA gjatë vlerësimeve të organeve të vlerësimit të konformitetit (CAB) në të gjithë Shqipërinë. Vlerësimi u krye në distancë në përputhje me EA2/02 dhe "Politikën EA MAC dhe procedurën për vlerësimet në distancë gjatë pandemisë COVID-19" (versioni 0, datë 2020-10-19). Vlerësimi është kryer në përputhje me kërkesat e specifikuar në standardin ndërkombëtar ISO/IEC 17011:2017, Rregulloren (EC) Nr. 765/2008 dhe standardet dhe kriteret përkatëse të miratuara nga EA, ILAC ose IAF.

Në raportin e vlerësimit të ndërsjelltë theksohet që: *DPA operon akreditimin e laboratorëve testues (EN ISO/IEC 17025), organeve të inspektimit (EN ISO/IEC 17020), organeve të certifikimit të sistemit të menaxhimit (EN ISO/IEC 17021-1) dhe organet e certifikimit të personave (EN ISO/IEC 17024) në përputhje me kërkesat e ISO/IEC 17011:2017* Grupi i vlerësimit të ndërsjelltë të EA është i impresionuar me strukturën organizative të DPA-së dhe aftësitë dhe njohuritë e personelit të DPA-së lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e tyre të sistemit të cilësisë. Grupi do të donte gjithashtu të nënvizonte plotësisht çiltërsinë dhe transparencën e treguar nga menaxhmenti dhe i gjithë personeli i DPA-së për të treguar një pasqyrë të saktë e operacioneve të përditshme të DPA-së gjatë gjithë vlerësimit të ndërsjelltë".

DPA e përfundoi me sukses këtë proces vlerësimi në praktikë. Kështu, marrëveshjet shumëpalëshe në fushat e testimit, inspektimit, certifikimit të personave dhe sistemeve të menaxhimit mbeten të vlefshme. Kjo siguron përsëri njohjen e sistemit kombëtar të akreditimit dhe shërbimeve të vlerësimit të konformitetit. Raportet dhe certifikatat nga OVK e akredituar njihen globalisht, gjë që promovon besimin në cilësinë e produkteve dhe shërbimeve përkatëse.

Shiko me teper raportin e EA MLA per vitin 2021: <https://european-accreditation.org/ep-content/uploads/2022/04/EA-MLA-report-2021.pdf>

DPA vlerëson dhe akrediton OVK në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe specifikimeve teknike. Akreditimi synon të rrisë besimin në kompetencën dhe shërbimet e OVK të akredituar në mbarë botën.

Si një organ kombëtar akreditimi dhe anëtarë i EA, DPA i nënshtrohet vlerësimeve të rregullta të ndërsjellta, me fjalë të tjera një vlerësimi mes të barabartëve. Ky vlerësim bazohet në kriteret dhe metodat vlerësimi të argumentuara dhe transparente dhe është i detyrueshëm për të gjithë anëtarët me "status nënshkrues" si pjesë e marrëveshjeve shumëpalëshe (marrëveshje shumëpalëshe, MLA, dhe marrëveshjet shumëpalëshe të njohjes, MRA) nga EA, Bashkëpunimi Ndërkombëtar i Akreditimit të Laboratorëve (ILAC) dhe Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit (IAF).

Gjatë vlerësimit të ndërsjelltë vlerësohet nëse organi kombëtar i akreditimit plotëson kërkesat e standardit ndërkombëtar EN ISO/IEC 17011 "Kërkesat e përgjithshme për organizmat e

akreditimit që akreditojnë organet e vlerësimit të konformitetit" dhe dokumentat detyruese nga EA, ILAC dhe IAF dhe i zbaton këto në akreditimin e vet.